



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 6315 / Prot.

Tiranë, më 24.08. 2026

URDHËR

Nr. 436, datë 24.08. 2026

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 24, DATË 23.1.2020, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR DHE PJESËMARRJEN E NXËNËSVE NË OLIMPIADAT
NDËRKOMBËTARE"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në Rregulloren, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e urdhrin nr. 24, datë 23.1.2020, "Për miratimin e rregullores së olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - a) Kudo në përmbajtje, emërtimet "*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*" të zëvendësohet me "*Ministria e Arsimit*", "*Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*" të zëvendësohet me "*Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar*", dhe shkurtimet "*MASR*" dhe "*DPAP*" të zëvendësohen me "*MA*" dhe "*AKAP*".
 - b) Shkronja "b", e nenit 4, të kreut I, ndryshohet si vijon:

"b) Në AML zhvillohen olimpiadat për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji, informatikë, gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi dhe gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht."
 - c) Në nenin 6 të kreu III togfjalëshi "sipas "Udhëzuesit vjetor të zhvillimit të olimpiadave kombëtare, për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, për vitin shkollor 2019-2020", nr. 10250 prot., datë 15.11.2019", shfuqizohet.
 - d) Në ndarjen II, të nenit 6, shkronjat "q" dhe "x", ndryshohen si vijon:

- “q) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen zyrtare të QSHA-së dhe MA, pas përfundimit të fazës së dytë.*
- x) Pas përfundimit të fazës së dytë, si dhe afatit të ankimit, sipas procedurës së parashikuar në nenin 9, rezultatet përfundimtare të nxënësve fitues dërgohen zyrtarisht nga ZVAP në DRAP/ AKAP dhe AKAP-i i dërgon MA dhe QSHA, 15 ditë para fillimit të fazës së tretë të Olimpiadës për lëndët përkatëse.”.*
- e) Në ndarjen III, të nenit 6, togfjalëshi *“me mbi 70% të pikëve”* zëvendësohet me togfjalëshin *“jo më pak se 70% të pikëve”*.
- f) Në ndarjen III, të nenit 6, shkronja *“o”*, ndryshohet si vijon:
“o) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen zyrtare të QSHA dhe MA pas përfundimit të olimpiadës përkatëse.”.
- g) Pikat 3 dhe 4, të nenit 7, të kreu IV, ndryshohen si vijon:
“3. Përputhja e barkodeve me emrat e nxënësve të rezultateve paraprake, bëhet në QSHA, në prani të përfaqësuesit të MA.
4. Emrat e fituesve të rezultateve paraprake dhe rezultateve përfundimtare të olimpiadave kombëtare, publikohen në faqen zyrtare të MA dhe QSHA.”.
- h) Në nenin 8 pas shkronjës *“b”* shtohet shkronja *“c”*, me përmbajtje si më poshtë:
“c) Kandidati i përzgjedhur për të përfaqësuar vendin në olimpiadat ndërkombëtare, i cili rezulton fitues i vendit të parë, të dytë dhe të tretë, në fazën e tretë të olimpiadave kombëtare, i cili aplikon për mbështetje financiare sipas vendimit nr. 120, datë 27.2.2026 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për organizimin, të kriterëve, të mënyrës së mbështetjes dhe të masës të shpërblimit financiar për të rinjtë në programet e talenteve rinore”, pajiset me aktin e miratimit të pjesëmarrjes së lëshuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.”.
- i) Shkronjat *“e”* dhe *“h”*, të nenit 9, të kreut IV, ndryshohen si vijon:
“e) ZVAP grumbullon ankimet dhe i përcjellë ato bashkë me testet në DRAP, i cili e përcjell në QSHA dhe AKAP, brenda 12 ditëve.
 ...
h) Për të shqyrtuar ankimin e nxënësve në fazën e tretë, MA ngre komisionet sipas profileve me 3 (tre) përfaqësues, një nga ASCAP dhe dy mësues të lëndëve përkatëse nga AKAP.”.
- j) Pas shkronjës *“h”*, të nenit 9, të kreut IV, shtohet shkronja *“h/l”* me përmbajtje si më poshtë:

“h/1) Për fazën e tretë kërkesa për rivlerësim të testit depozitohet nga nxënësi/kujdestari ligjor në QSHA.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI

